



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN  
DREJTORIA

Nr. \_\_\_\_ .Prot.

Peqin , më \_27\_. \_02\_.2019.

**KRYETARI**

**Saimir HASALLA**

**RELACION TEKNIK**

**Rikonstruksion I godines dhe adaptimi I saj ne banim per famijet ne nevoje !**

**Vendndodhja : Peqin – Bashkia Peqin**

**Siperfaqja totale e godines = 437m<sup>2</sup>**

**Projekti per rikonstruksionin e godines dhe adaptimin e saj ne godine banimi per familjet ne nevoje eshte hartuar mbi bazen e detyres se projektimit te vene ne dispozicion nga bashkia Peqin .**

**Synimi I detyres ka qen per te realizuar nje projekte me standarte , duke rikonstruktuar te gjithe godinen egzistuese por duke shtuar dhe disa elemente te tjere ( si shkalle ,hapesire te gjelber etj).**

Gjithashtu është menduar që të nderhyet në fasaden egzistuese duke e rimodeluar dhe të dhënë objektit një impakt të ri .

Godina e vënë në dispozicion për këto qëllime është dhënë nga Bashkia Peqin dhe ka një sipërfaqe totale prej 437m<sup>2</sup>.

Në godinën egzistuese do të projektohen 8(tete) ambiente banimi 1+1 , si dhe do të vishet e gjithë fasada e jashtme me termoizolim me sistem kapot, Sistemet e izolimit termik janë një mundësi optimale për të reduktuar ndjeshëm harxhimin e energjisë. Ato reduktojnë prodhimin e lëndëve të dëmshme për ajrin, mbrojnë burimet e energjisë dhe japin një kontribut të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit. Termoizolimi në objekte banimi është faktor shumë i rëndësishëm për arritjen e komfortit temperaturor të banuesve. Termoizolimi zvogëlon humbjet e energjisë duke shmangur shpenzimet e tepërta dhe zvogëlon nevojën për energji duke mundësuar që temperaturat e brendshme të arritura në shtëpi të zgjasin dhe të mbesin sa më gjatë brenda shtëpisë. Kjo vlen për temperaturat e ngrohta të arritura gjatë dimrit por gjithashtu për ambient sa më të freskët gjatë verës.

### Avantazhet e sistemit termoizolues.

- Parandalon dëmtimin e mureve si rezultat i kushteve klimaterike.
- Parandalon depërtimin e temperaturave të jashtme në brendësi të ndërtesës dhe anasjelltas.
- Kërkesa të ulta për burime energjitike (ngrohje, ftohje) gjë që siguron dhe kosto më të ulta.
- Parandalon problemet që lidhen me lagështirën (mykun dhe krijimin e njollave të zeza dhe largon insektet).
- Mbulon në mënyrë definitive qoshet, kolonat dhe perimetrat e dritareve.
- Nuk ngushton hapsirën e ndërtesës duke qënë se punohet vetëm në pjesën e jashtme të saj.
- Lejon ruajtjen e karakteristikave arkitekturore të ndërtesës.
- Sipërfaqja e sapo termoizoluar përfiton një pamje të re, të qëndrueshme dhe me një strukturë bashkëkohore.

**Duke u bazuar ne gjendjen egzistuese te objektit te konstatuar nga inspektimi I kryer ne terren , per realizimin e objektivave te projektit jane parashikuar nderhyrjet si me poshte:**

- **Prishje murature guri dhe tulle me siperfaqe 67.2m3 .**
- **Ndertim I mureve te reja me gips per krijimin e hapsirave te brendshme**
- **Zevendesim i shtresave te gjitha ambjenteve me parket laminat (ambjentet e ndejtjes ,fjetjes) me pllaka porcelain cilesi e pare ( koridori I perbashket ) dhe pllaka manjolike (NHS)**
- **Do te behet veshja e fasades se jashtme me termoizolim sistem kapot si dhe lyerja e saj me boje hidroplastike cilesi e pare .**
- **Te gjitha ambjentet e brendshme do te suvatohen**
- **Do te behet zevendesimi I te gjitha dyerve dhe dritareve egzistuese me te reja sipas projektit**
- **Per dy ambjente ne vecanti do te ndertohen dhe dy shkalle te reja ne funksion te tyre**
- **Do behet heqja e catise egzistuese dhe rimodelimi I saj ne forme dhe strukture**